



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA KLOS**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

**Klos, më 21/07/2023**

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** "Ndërtim Urë Beton-Arme 4\*7 m mbi lumin Mat, në Fshatin Dom, Njësia Administrative Gurrë, Klos".

---

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45221100-3,  
Punime ndërtimi për ura.**

---

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 83,204,497 (*Tetëdhjetë e tre milion e dyqind e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë*) lekë pa t.v.sh, nga të cilat për vitin 2023 është në dizpozicion fondi prej 40,727,593 lekë pa t.v.sh me transfertë të kushtëzuar dhe për vitin 2024 është në dizpozicion fondi prej 42 476 904 lekë pa t.v.sh me transfertë të kushtëzuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Bashkia Klos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin*

ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.1.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontrates në procedurën e prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

---

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohe, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.1.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2022.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2022, sipas të dhënave të QKB-së.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

## **2.2 Kapaciteti teknik:**

2.2.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates.

- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogel se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht:
- **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**
  - Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudit;
  - Faturat tatimore
- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :
  - Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Fatura tatimore perkatese.
- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vleren 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve jur Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:
  - NP – 1/A Punime germimi ne toke.
  - NP – 4/A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
  - NP – 5/C Punime nentokesore, ura e vepra arti.
  - NP – 12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:
  - N.S -1A Punime per prishjen e ndertimeve
  - NS – 6/A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
  - N.S -7/A Barriera dhe mbrojtje rrugore
  - NS – 9/C Punime strukturore speciale
  - NS -18/A Punime topogjeodezike
  - NS – 20/A Shpime Gjeologo – inxhinierike, puse e shpime per uje

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet

teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1. A	Punime gjurmimi në tokë	Percaktimet ne preventiv	0-20 mln leke	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
N.P- 4 A	Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista Aeroportuale	Percaktimet ne preventiv	0-20 mln leke	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
NP – 5 C	Punime nentokesore, ura e vepra arti.	Percaktimet ne preventiv	51 – 100 mln	E kalon vleren 50 milion
N.P-12 A	Punime te inxhinerise se mjedisit	Referuar projektit dhe specifikimeve teknike	0-20 mln leke	0 leke
N.S-1. A	Punime per prishjen e ndertimeve	Percaktimet ne preventiv	0-20 mln leke	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
N.S-6. A	Sinjalistike rrugore jo ndricuese	Percaktimet ne preventiv	0-20 mln leke	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
N.S-7. A	Barriera dhe mbrojtje rrugore	Percaktimet ne preventiv	0-20 mln leke	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
N.S-9. C	Punime strukturore speciale	Percaktimet ne preventiv	51-100 mln leke	E kalon vleren 50 milion
N.S-18. A	Punime topogjeodezike	Referuar projektit dhe specifikimeve teknike	0-20 mln leke	0 leke
NS – 20/A	Shpime Gjeologo – inxhinierike, puse e shpime per uje	Percaktimet ne preventiv	0-20 mln leke	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licënsa për Transportim i mbetjeve te parrezikshme **kodi III.2.B**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim Nr. 538 date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa”, si dhe në

përbushje të detyrimeve ligjore që përcakton Ligji 10431 date 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (të ndryshuar).

Duke qenë se në preventivin e punimeve janë pasqyruar punime prishje, gjurmimi është gjykuar që subjekti duhet të ketë lejen e posacme për veprimtari të tilla si Stacionim transferimi per mbetjet nga prishjet dhe ndertimet, per mbetjet e ngurta urbane dhe magazinim i perkoshem i tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat/lejet profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e proceseve te punes te parashikuara ne preventivin objekt kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoare prej **minimalisht 60 persona** për periudhën, (prill 2023 - qershor 2023), e vertetuar kjo me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per periudhen e fundit te deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohej nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e fundit te deklaruar.

**Shënim:** Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,** të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”

**Argumentimi:** Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale te lejuar qe duhen per te permbushur kontraten. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje (prill 2023 - qershor 2023) , tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtoare të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosja e kriterit për një punësim te paktën 120 persona duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike jane bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).Bazuar ne kater elementet e struktures se koston(material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

### **2.2.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:**

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Mars 2023 – Maj 2023, konkretisht:
- 1 Inxhinier Ndërtimi ,
  - 1 Inxhinier Ndërtimi (profili strukturist)
  - 1 Inxhinier Hidroteknik ,
  - 1 Inxhinier Gjeolog ,
  - 1 Inxhinier Gjeodet,
  - 1 Inxhinier Mjedisi

**Per stafin e mesiperm, duhet të paraqitet - Kontratë pune të vlefshme me noter, Diploma profesionale, CV**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, të ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” bazuar në përlogaritjen e oreve të punës , kategorite e punimeve të përcaktuara në preventive, specififikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zerave të punimeve , të cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik të kërkuar nga AK , si edhe bazuar në dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt të objektit.

**2.2.5** Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), **Drejtuësin Teknik të punimeve në objekt** i cili të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe që do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt , i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”

*(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunitimit).*

**Argumentimi: Argumentimi:** *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

*Së dyti*, vendosja e këtij kriteri mbështetet në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4.1, ku përcaktohet se *drejtuesi i kantierit sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga sipërmarrësi ose nga drejtuesit e kantierit (drejtori i punimeve/përgjegjësi teknik i kantierit), që emërohen prej tij. Në rastet kur drejtuesi ligjor e teknik i sipërmarrësit nuk udhëheq drejtpërdrejt punimet në kantier njoftohet, zyrtarisht, investitori për drejtuesit e punimeve dhe personat e tjerë, të emëruar me detyrë në kantier.*



*Së treti duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit., gjithashtu jemi në kushtet e parashikuara në pikën 2.1 të Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” ku përcaktohet se: “Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimit”.*

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

#### **2.2.6** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- **1 (një) punonjes i pajisur me certifikate si Specialist për ndihmën e pare, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq.** Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit si specialist per dhenien e ndihmes se pare, kontrata e punes dhe CV. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.*
- **1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune” si dhe kontrata e punes. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.*

***Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.***

***Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.***

**Argumentimi 2.2.7:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 .... Sherbimet e mbrojtjes dhe te parandalimit ... 1. Punedhenesi ngarkon nje ose disa punemarres, qe te merren me ceshtjet e mbrojtjes, te sigurise e shendetit ne pune dhe te parandalimit te rreziqeve profesionale ne ndermarrje /institucion ....., dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier". Autoriteti Kontraktor ka qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi sipas kushteve te percaktuara ne DST, duke respektuar cdo rregull lidhur me kantierin e ndertimit si dhe me sigurine e punonjesve gjate ushtrimit te veprimtarise se punes. Eshte e rendesishme qe punimet te realizohen brenda nje kantieri te sigurt duke mbrojtur jeten e punonjesve, por dhe te kalimtareve qe mund te jene perreth vendit te punimeve. Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune", nepermjet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe mund te cenoje shendetin apo sigurine ne pune. Ne keto kushte, vendosja e ketij kriteri sherben si nje garanci qe ofertuesit do te realizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi.

Bazuar dhe ne V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

2.2.8 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf mbështetes per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome/deshmi profesionale përkatëse leshuar nga institucione e njohura nga autoritetet pergjegjese shteterore, si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi per për periudhën Mars 2023 – Maj 2023, si më poshtë:

- 1 Inxhinier Transporti/ infrastrukture,
- Teknik Ndertimi – 2 punonjes
- Teknik Topograf – 1 Punonjes
- Karpentier/betonues – 10 punonjes
- Hekurkthyes – 3 Punonjes
- Hidroizolues – 2 Punonjes
- Mekanik – 1 punonjes
- Saldator – 2 punonjes

Per inxhinierin e Transporti/ infrastrukture, duhet te paraqitet - Kontratë pune te vlefshme me noter, Diploma profesionale, CV

Per tekniket e ndertmit, teknikun topograf dhe mekanikun do te pranohen vetem diplomat e shkolles se mesme profesionale ose licensat perkatese.

**Shënim:** Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.

**162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.**

**Argumentimi :** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar (kapaciteti teknik në DST). Stafin teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik sipas pikës 3.5, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmimeve të kualifikimit të sigurimit teknik.

2.2.9 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

- Eskavatorist – 2 punonjes
- Automaknist – 2 punonjes
- Buldozerist – 1 punonjes
- Shofer kamioni – 1 punonjes

Per manovratorët dëshmitë e aftësisë profesionale nga DPSHTRR, te cilat duhet te jene te vlefshme dhe te figurojne ne listepagesa për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund te disponohen së bashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojte te jene te perfshire ne listpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

**Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.**

**Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj,

që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar (kapaciteti teknik në DST). Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik sipas pikës 2.2.9, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore.

**2.2.10** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës konkretisht:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Ekskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Mini ekskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Mjet transporti vetëshkarkues mbi 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Kamion me vinç	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Fadroma me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
7	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Automjet me vinç me kosh	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Kamionçine 1 -3 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
13	Autovinç me kapacitet ngrites min 50 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Rul asfalti cilindër - cilindër mbi 8 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 2
18	Motosaldatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Motokompresore	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Sonde Shpimi me diametër 1m	në pronësi ose me qira	Copë 1
21	Tabela sinjalistike	në pronësi ose me qira	Copë 20
22	Semafor të levizshëm me bateri	në pronësi ose me qira	Copë 2
23	Makinieri vijezi termoplastike (sprucator Past)	në pronësi ose me qira	Copë 1
24	Fabrike Betoni	në pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1
25	Fabrike asfalti	në pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: - çertifikatën e pronësisë, -leja e qarkullimit, - çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin dhe fotot përkatëse;

- Ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve;
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot, ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve;
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar ne procedura te shpallura fitues.

*Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kritereve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën i) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar mjetet / makinerite të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , bazuar ne tipologjine e zerave te preventivit , analizave perkatese te zerave te preventivit etj, nga specialistet perkates te inxhiniere, nga grupi i punes per perllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve te vecanta teknike te kualifikimit .

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” si edhe nga praktika te meparshme te ngjashme. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

### **2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë të përcaktuara si më poshtë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** ose ekuivalente (e vlefshme).

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** ose ekuivalente (e vlefshme).

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **OHSAS 18001-2007 ose 45001-2018** ose ekuivalente (e vlefshme).

Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

*Argumentimi* : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë..

-Përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

-Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe. Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe.

**Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve janë pjese e DST.*

**Data: 20/07/2023**

## **NJËSIA E PROKURIMIT**

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_